



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 76/1 Prot.

Tiranë, më 28/12/2011

Lënda: Rekomandim për “Çelësi Desing & Publicity” sh.p.k, Tiranë.

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit, në ngarkim të kontrolluesit “Çelësi” sh.p.k, Tiranë,

KONSTATOVA

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar inspektim administrativ pranë kontrolluesit “Çelësi Desing & Publicity” sh.p.k, me objekt:

Instalimi, përdorimi, mbikëqyrja dhe regjistrimi me anën e “Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi” (CCTV), në ambientet dhe në territorin e kontrolluesit “Çelësi” sh.p.k Tiranë.

-Verifikimi i përdorimit të këtyre kamerave bazuar në nenet 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe udhëzimin nr 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme” në lidhje me:

- Qëllimin e përpunimit të imazheve, si të dhëna personale me karakter të veçantë fizik;
- Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të këtyre të dhënave përkundrejt qëllimit;
- Saktësinë dhe qartësinë në përpunimin e imazheve, gjatë vëzhgimit dhe regjistrimit të tyre;
- Kohën e ruajtjes së imazheve filmike apo fotove të gjeneruar nga sistemi i ruajtjes dhe i regjistrimit;
- Kategoritë e subjekteve që ju përpunohen imazhet dhe mënyrat e përpunimit të tyre për identifikimin e subjekteve;
- Përhapjen e të dhënave të mbledhura e të përpunuara me anën e CCTV-ve, tek të tretët;
- Numrin e kamerave të vendosura në ambientet dhe në territorin e kontrolluesit dhe nëse ka instalime të kamerave të fshehta.

Ezaurimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave, kategorive që ju përpunohet e dhëna “imazhe”, me anën e “Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi” (CCTV), bazuar në nenet 12,13,18,19 të ligjit nr. 9887, dt 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe në udhëzimin nr.3 date 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave

